

Flet për “Epokën e re” Sadri Ferati

NË VERI SHTETI DUHET TË VERPROJË FUQISHËM

Të gjithë themi se procesi i decentralizimit në Mitrovicën veriore do të jetë më i vështirë për shkak të veprimeve që i bën politika e Beogradit dhe strukturat paralele. Dhe është ashtu.

Është e vërtetë se në veri kemi mungesë të madhe të sundimit të ligjit. Për të mekanizmat dhe institucionet e Kosovës duhet të veprojnë më fuqishëm për ta shkurtuar kohën, që pastaj pjesa tjetër të mund të veprojë për ta zbatuar projektin tonë, organizmin e zgjedhjeve në Mitrovicë dhe instalimin e strukturave komunale në Leposaviq, Zveqan dhe në Zubin Potok

Mal QORRAJ

Prishtinë, 20 maj

EPOKA E RE: *Z. Ferati, cili është rezultati i dalë deri më tash nga procesi i decentralizimit?*

Ferati: Decentralizimi ka qenë proces jo i lehtë. Është përcjell me paragjykime dhe kritika të mëdha. Megjithatë, Kushtetua e Republikës së Kosovës dhe ligjet e saja ishin një mundësi e mirë që të instalojmë institucione të fuqishme, që t’u japim mundësi qytetarëve për ta përmirësuar kualitetin e jetës. Në këtë kontekst mendoj se janë tejkaluar edhe shumë pasoja që kanë mbetur nga lufta.

Decentralizimi ka mundësuar që edhe komunitetet joshumicë të integrohen në shoqërinë kosovare. Mendoj se rruga deri këtu ka qenë e suksesshme. Ky është vlerësim edhe i partnerëve, por dhe i opinionit të gjerë. Kemi përfunduar bartjen e kompetencave të disa komunave, me përjashtim të komunave të pjesës veriore: Leposaviq, Zveqan, Zubin Potok. Mund të konsiderohet sukses edhe mbajtja e zgjedhjeve lokale, që për herë të parë janë organizuar nga institucionet e Republikës së Kosovës, ku kemi pasur një dalje solide të qytetarëve të komunitetit serb në votime si në Graçanicë, Kllokot, Ranillug dhe në pjesën e zgjeruar të Novobërdës. Pra, si rezultat i decentralizimit kemi tani themelimin e tri komunave të reja në këto lokalitete.

Jemi duke punuar dhe po bëjmë të pamundurën që këto komuna të bëhen funksionale. Këto janë rezultate që tashmë janë evidente, por ka mbetur ende shumë për të bërë.

EPOKA E RE: *Çfarë konkretisht ka mbetur pa u realizuar nga ky proces?*

Ferati: Sa i përket decentralizimit kanë mbetur pa u themeluar ende dy komuna, sepse, siç dihet me ligjin për kufijtë administrativë, Kosova definohet me 38 komuna. Pra, nuk është proceduar me zgjedhje për komunën e Parteshit dhe Mitrovicës, për arsye që tashmë dihen, ngase atje nuk është shënuar progres i nevojshëm që të themelohen institucione që do t’u kishin shërbyer qytetarëve pa dallime nacionaliteti.

Ndërsa në komunat e reja instalimi i strukturave komunale ka shkuar mirë. Tanimë kemi administratë që po funksionon.

Përveç instalimit të kryetarit, asamblesë komunale dhe të drejtorëve të drejtorive që kanë shkuar më shpejt, bartja e resurseve nga komunat amë, që nga gjendja civile, librat amzë që duhet t’i nxjerrim shënimet, pastaj fusha e tatimit në pronë, kadastrës, urbanizmit dhe

shënimet e tjera në arsim dhe shëndetësi, janë procese që po shkojnë pak më ngadalë. Ajo që duhet veçuar në këtë rast është se vërtet ekziston një vullnet i mirë i bashkëpunimit ndërmjet komunave amë dhe komunave të reja.

EPOKA E RE: *Cili është bashkëpunimi i Ministrisë së Pushtetit Lokal me përfaqësuesit e komunave të reja?*

Ferati: Kemi bashkëpunim shumë të mirë me liderët e institucioneve të komunave të reja, por edhe të komunave amë. Më herët, po jo gjithmonë, ka pasur mirëkuptim, dhe angazhim të komunave amë. Ka pasur edhe ngecje. Diku ka pasur deklarime se nuk i kanë shkuar shumë përshtati këtij bashkëpunimi. Por konsideroj se këto tani janë të tejkaluar. Dhe sot, mund të vlerësoj se të gjithë kryetarët dhe strukturat komunale amë dhe të komunave të reja janë duke bashkëpunuar mirë. Mund të them se jemi në proces të mirë të përfundimit të bartjes së të gjitha resurseve në komunat e reja.

Në veri kemi mungesë të sundimit të ligjit

EPOKA E RE: *Si i konsideroni paralajmërimet për mbajtjen e zgjedhjeve serbe në veri?*

Farati: Qëndrimi ynë tashmë dihet, ne nuk i mirëpresim, sepse po vazhdohet me ambicie të instalimit të strukturave jolegale, të cilat struktura asnjëherë në objektivin e tyre nuk kanë pasur qëllim jetën e qytetarëve, krijimin e institucioneve të fuqishme, bashkëjetesën dhe barazinë qytetare, por strukturat jolegale kanë funksionuar mbi ambiciet e vjetra të luftës për territore dhe të një përçueshmërie të një politike ditore të Beogradit në të gjitha ato lokalitete ku janë instaluar. Është fat i mirë se zgjedhjet nuk pranohen nga institucionet e Republikës së Kosovës, po ashtu as nga partnerët tanë ndërkombëtarë.

Natyrisht se këto zgjedhje mund të krijojnë pengesa varësisht nga lokaliteti, por nëse i referohemi zgjedhjeve që do të mbahen tash në Mitrovicë, e vonojnë pak procesin tonë. Pra, mund të ndikojnë në klimën atje. Por them se përfundimisht nuk do të pengojnë në implementimin e këtij projekti (decentralizimi), por mund të krijojnë një ngadalësim të procesit. Të gjithë e themi se procesi i decentralizimit në Mitrovicën veriore do të jetë më i vështirë, pikërisht për shkak të veprimeve që i bën politika e Beogradit dhe strukturat paralele. Në veri kemi një mungesë të madhe të sundimit të ligjit, dhe kjo është arsye që do të duhej paraprakisht që mekanizmat dhe institucionet e Kosovës të merren me sundimin e ligjit, pra të veprojnë më fuqishëm për ta shkurtuar kohën, që pastaj pjesa tjetër të mund të veprojnë për ta implementuar projektin tonë, organizmin e zgjedhjeve në Mitrovicë dhe instalimin e strukturave komunale në Leposaviq, Zveqan dhe në Zubin Potok.

EPOKA E RE: *Besoni në sukses?*

Ferati: Gjithsesi, që do të kemi sukses nëse krijojmë një ambient të mirë që të mbahen zgjedhjet. Natyrisht se strukturat e reja që do të dalin, ato kanë për interes që të funksionojnë vetë si të tilla dhe t'u ofrojnë shërbime qytetarëve. Fare nuk dyshoj në suksesin e funksionimit të këtyre strukturave, ngaqë, sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, me ligjet dhe financat lokale komunat e Kosovës janë më të fuqishmet në regjion. Mundësia e liderëve lokalë dhe qytetarëve që t'i menaxhojnë ato resurse dhe ato kompetenca është shumë e madhe. Dilemë tani është se ne nuk mund të flasim se për sa kohë do të bëhet kjo, ngase rezistenca është shumë e madhe. Thash edhe më herët se

kemi mungesë totale të sundimit të ligjit dhe kërkojmë një mirëkuptim prej të gjithë atyre të cilët dëshirojnë që ky proces të jetë më i shpejtë. Tani për tani ne as qasje fizike nuk kemi në veri.

EPOKA E RE: *Pse atëherë nuk merrni veprime për ta ndryshuar gjendjen në veri?*

Ferati: Është një ambient tejet i pasigurt. Në radhë të parë për qytetarët atje. Të gjithë ata qytetarë me të cilët jemi në kontakt shumë lehtë mund të krijojnë kontakt me ne në Prishtinë, por kur të kthehen në mesin ku jetojnë, ata nuk dëshirojnë që rrethi i tyre ta kuptojë se janë duke biseduar për mundësinë progresive dhe më moderne. Ata qytetarë janë të frikësuar. Ne nuk kemi mekanizma që t'i mbrojmë qytetarët të cilët i shprehin lirshëm mendimet e tyre, që lirshëm ta bëjnë organizmin e tyre politik dhe lirshëm të bisedojnë për çështjet në interes për jetën e tyre. Kjo mungesë e sundimit të ligjit është duke e cenuar dhe vonuar interesin e vet qytetarëve në veri, gjithashtu edhe ndihmën tonë që do t'ua kishim dhënë së pari.

Por me përpilimin e strategjisë, e cila është përkrahur edhe nga bashkësia ndërkombëtare, u jepet përkrahje ambicieve dhe përkushtimit të Republikës së Kosovës që të jetë prezent në veri dhe t'u ofrojë ndihmë qytetarëve. Kemi obligim si institucione që të jemi afër atyre qytetarëve, sepse ata nuk jetojnë mirë. Sipas të gjitha sondazheve, janë të pakënaqur me jetën dhe dëshirojnë që ta përmirësojnë kualitetin e jetës.

EPOKA E RE: *Z. ministër, çfarë bashkëpunimi keni me koordinаторin e Qeverisë për veriun, z. Ylber Hysa?*

Ferati: Kabineti qeveritar ka vazhduar mandatin e Grupit Ndërmintor për decentralizim edhe për dy vjetët e ardhshëm. Ne do të vazhdojmë t'i ushtrojmë përgjegjësitë dhe obligimet e tjera, që nënkupton se obligimet tona janë për të krijuar një ambient të përshtatshëm për ta formuar komunën në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, njëkohësisht për t'i funksionalizuar komunat Leposaviq, Zveqan dhe Zubin Potok.

Veprimet tona në këtë rast do të duhej të shoqëroheshin edhe më shumë me veprime anësore, duke filluar edhe me investime, me një zhvillim socio-ekonomik të atyre lokaliteteve për ta rritur interesin e qytetarëve për bashkëpunim me institucionet e Republikës së Kosovës.

Prandaj, ky është një proces gjithëpërfshirës. Deri më tani nëpërmjet Grupit Punues ka pasur përfaqësues nga pozita, opozita dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Unë do të bashkëpunoj me të gjithë akterët të cilët do të përfshihen, e që do të jenë të dobishëm për ta avancuar këtë proces më tutje.

Kryeministri e udhëheq Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ai është kompetent që të bëjë autorizime dhe vendime, ashtu si i ka marrë edhe për Grupin Ndërmintor. Kryeministri ka të drejtë të ketë edhe këshilltar dhe të ndërtojë kapacitete rreth tij. Unë si ministër dhe Grupi Ndërmintor do të bashkëpunojmë me të gjithë akterët të cilët do ta ndihmojnë këtë proces. Por Grupi Ndërmintor dihet se si do të funksionojë. Ky grup do të vazhdojë të kryesohet nga unë, si ministër i Republikës së Kosovës dhe nga z. Piter Feith, si shef i Zyrës Civile Ndërkombëtare.

EPOKA E RE: *Keni komplikime në relacionet e bashkëpunimit të Grupit Ndërmintor dhe koordinatorit?*

Ferati: Nuk mund të them diçka në këtë drejtim, se nuk kam pasur rast që të ulemi dhe të bisedojmë me kryeministrin Thaçi, z. Hysa dhe me të tjerët për të parë se si do të jetë roli i secilit dhe si do të mund të funksionojmë më mirë.

Por përderisa jam i caktuar ta udhëheq gjithë procesin, do të punoj fuqishëm që të ecim përpara.

Nuk jam takuar me Ylber Hysen

EPOKA E RE: *Mos nënkupton kjo se nuk ka qenë e nevojshme që z. Hysa të emërohet koordinator për veriun?*

Ferati: Jo. Jam duke provuar të them se nuk bëhet fjalë për interferim, nuk bëhet fjalë për dulifikim. Kompetencat e Grupit Ndërmintoror janë të qarta dhe ky grup do ta vazhdojë punën e tij. Ndërsa kryeministri, si mbikëqyrës i gjithë procesit, ka të drejtë që rreth vetës të ketë kapacitete që do t'i ndihmojnë. Dhe z. Hysa e shoh në këtë rol, duke i ndihmuar kryeministrin, në mënyrë që kryeministri të ketë informacione të bollshme në raport me procesin.

EPOKA E RE: *Po pse deri në këtë kohë nuk jeni takuar me z. Hysa?*

Farati: Po thjesht nuk kam pasur rastin që të takohem. Prandaj, edhe nuk e di se cila është ideja e kryeministrin dhe as e z. Hysa në raport me fushën e përgjegjësiive që i ka Grupi Ndërmintoror.

EPOKA E RE: *Si mund t'i koordinoni punët kur ju nuk jeni takuar asnjëherë?*

Ferati: I mbetet kohës që të shikojmë. Por mostakimi nuk mund të jetë pengesë që Grupi Ndërmintoror të mos vazhdojë punën. Grupi Ndërmintoror do ta vazhdojë punën, sepse e ka marrë besimin e kabinetit qeveritar dhe kryeministrin Thaçit.

EPOKA E RE: *Z. ministër, cili është bashkëpunimi me ICO-n?*

Ferati: Deri më tani në fazën paraprake kemi pasur bashkëpunim të mirë me ICO-n dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë. Gjithashtu, përkrahje të fuqishme kemi nga të gjitha ambasadat që janë të pranishme në Kosovë. Si Grup Ndërmintoror kemi pasur koordinim të mirë edhe me ministrat kolegë, kemi pasur mbështetje nga liderët e shtetit, presidenti Sejdiu, kryeparlamentari Krasniqi dhe, sigurisht, nga kryeministri Thaçi, pasi është pjesë e procesit, por edhe nga institucionet e tjera që nuk janë të instaluar direkt në Kosovë, përfshirë këtu Këshillin e Evropës, Grupin Ndërkombëtar Drejtues dhe institucionet e tjera ndërkombëtare.

EPOKA E RE: *Përpos planit të strategjisë, a duhet që institucionet e Kosovës të marrin edhe veprime të tjera shtesë për t'i integruar serbët në shoqërinë kosovare?*

Ferati: Ju tani e keni bërë një pyetje shumë bazike, që mund ta kapë esencën e problemit. Më e lehta është të mendosh se je kompetent, ke Kushtetutë, ke ligje, je një shtet që po krijon ofertë të mirë për qytetarët... por duke marrë parasysh se cila është situata në veri, mendoj se do të na duhen me qindra veprime që ta shërojmë situatën, që atje të krijojmë parakushte të mjaftueshme, në mënyrë që qytetarët të jenë pjesë aktive në këtë proces. Qytetarët në veri nuk do të mbesin pa përkrahje, ata do ta kenë dorën e shtrirë të

institucioneve të Republikës së Kosovës. Pra, nuk do të kenë vakum të përkujdesjes. Oferta jonë është shumë më e sigurtë sesa ajo që u vjen momentalisht nga Beogradi.

EPOKA E RE: *Z. ministër, sa herë e keni vizituar pjesën e veriut?*

Ferati: E kam vizituar shumë herë, por edhe me këtë nuk thash gjë. Me një vizitë nuk mund të thuash se gjendja atje ka ndryshuar dhe se ne atje jemi faktorë. Kam shkuar disa herë në veri, por sa herë që kam shkuar si ministër i Republikës së Kosovës, kam shkuar me përcjellje të policisë, kam shkuar për t'i respektuar qytetarët të cilët kanë shumë halle, të cilët jetojnë shumë keq. Akoma s'kam fjalë si ta përshkruaj situatën se si jetojnë ata qytetarë, sidomos në Kodrën e Minatorëve. Pra, akoma s'kemi ambient dhe situatë që të themi se institucionet e Kosovës mund të shkojnë, mund të punojnë dhe t'i përmbushin kërkesat e qytetarëve dhe pritjet e tyre.

EPOKA E RE: *A duhet që ta merrni vetë guximin e të hyni në veri pa përcjellje të policisë?*

Ferati: Besoj se kryeministrit, ministrave dhe shumë intelektualëve, as qytetarëve, nuk u mungon guximi për të shkuar në veri, por çështja është se në cilin ambient po shkojnë. Nuk bëhet fjalë se sa jemi të gatshëm e të guximshëm, por e them se ende në veri nuk kemi ambient që qytetarët serbë të jenë të lirë për të biseduar me ne. Qytetarët janë ata që frikësohen të jenë afër nesh. Unë nuk hezitoj për të shkuar në veri, jam i gatshëm edhe tash të nisëm, bashkë me mediet, por atje qytetarët janë të frikësuar me vetveten, nëse komunikojnë dhe bashkëpunojnë me institucionet e Kosovës.

Aty është obliguese dhe e domosdoshme sundimi i ligjit, që ata qytetarë të jenë të sigurt për të bashkëpunuar me institucionet e Kosovës.